



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog
Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

DATË/A:	26.06.2015
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Komisionin e RIK-ut 50 ZK. NënKomisionin e RIK-ut Lot2.
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z.Bashkim Shaqiri, Kryetar i Komisionit për RIK 50 ZK.
NGA/OD/FROM:	Vllaznim Vuçitërna, Projekt Menagjer RIK 50/ Lot 2
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kronologjia e punës në projektin e RIK-ut 50 ZK/ Lot2.

Bazuar në zhvillimin e projektit të RIK-ut në 50 ZK, përkatësisht Lot2, raportoje për realizueshmërinë e projektit si vijon:

- Si faze e parë e projektit të RIK-ut është Fushata e Informimit Publik. Kjo fushatë është zhvilluar konform UA. 04/12 nën udhëheqjen e Kryetarit të Komisionit të RIK-ut, ku janë informuar qytetarët për fillimin e projektit të RIK-ut. Fushata e Sensibilizimit të Publikut është zhvilluar në 25 Zona Kadastrale në 5 Komuna në të cilat është zhvilluar projekti. Në takime me qytetar kanë marr pjesë: Kryetari i Komisionit, antar i komisionit për çështje teknike dhe Menaxheri i projektit nga AKK si dhe zyrtar nga ZKK dhe përfaqësues nga OE. Ndërsa me fillimin e Informimit Publik:
 - Janë Informuar zyrtarët dhe drejtorit e Zyrave Kadastrale Komunale të cilat kanë qenë pjesëmarrëse në zgjedhjen e ZK të cilat përfshihen në projekt.
 - Informimi është bërë përmes pllakateve dhe fletëpalosjeve të shpërndara në 25 ZK, mediave lokale, formës së shkruar si dhe përmes ueb-faqes së AKK-së dhe ueb-faqeve të KK në të cilat zhvillohet projekti. Informimi është bërë në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze ku janë ftuar qytetarët së paku 7 ditë përpara për mbajtjen e takimit me Komisionin si dhe përfaqësuesit e OE.
 - OE ka siguruar hapësirat e përshtatshme për mbajtjen e takimit me banorët e ZK. Në takim, qytetarët janë Informuar për: rëndësinë e projektit, planin e rindërtimit,

dinamikën e realizimit, detyrat e AKK-së, detyrat e ZKK-së, përbërja dhe detyrat e Komisionit, detyrat e OE dhe detyrat e qytetarëve të ZK.

- OE gjithashtu ka bërë informim rreth matjeve të arave nëpër ZK, që pronarët ti përgatisin kufijtë e parcelave të tyre për arsye që kur të filloje me matjen e tyre mos të hasim në vështirësi, pasi që kjo ka rëndësi të veçantë te qytetarët.
- OE deri më tani ka dorëzuar matjet e terrenit për katërmbëdhjetë zona kadastrale në periudha të ndryshme kohore. Zona Kadastrale: Rashincë, Davidoc, Vojnoc, Muzeqinë, Gjurkoc, Graboc i Epërm, Leshkoshiq, Petroviq, Plemetin, Siboc, Bellanicë, Damanek, Kijevë dhe Runjevë. Pra, këtu janë përfshi të gjitha ZK prej qysh ka filluar procesi i matjeve në terren.
- OE ka raportuar për përfundimin e matjeve sistematike në 6 zona kadastrale. Zona kadastrale: Banjë, Drenoc, Paldenicë, Gorancë, Seqishtë dhe Begracë.
- OE ka raportuar se, në terren janë duke operuar gjithësejtë 6 ekipe në dy ZKK të ndryshme (Shtime dhe Kaqanik). Ekipet e njëta janë parë paraprakisht në zonat e caktuara gjatë monitorimit në terren nga Kontrolli i Kualitetit AKK.
- Në terren është startuar me matje edhe në ZK Malishevë me një intensitet të dobët, ndërsa në ZK Kaqanik ende nuk është filluar me matje.
- Bazuar në vendimet e Komisionit Shiqimi Publik ka përfunduar në 7 Zona kadastrale (Rashincë, Vojnoc, Gjurkoc, Muzeqinë, Davidoc, Leshkoshiq dhe Graboc i epërm), këto ZK janë të komunës Shtime dhe Obiliq, si dhe më datë 30.06.2015 fillon Shiqimi Publik në 6 ZK tjera. Shiqimi Publik do të fillojë në ZK. Banjë, Bellanicë, Drenoc, Damanek-(Malishevë), Siboc dhe Plemetin-(Obiliq).
- Me përfundimin e Shiqimit publik në këto shtatë zona kadastrale janë mbledhur gjithësejtë: 809 Procesverbale-lëndë, 2053 parcela finale dhe kanë qenë pjesëmarrës 1041 qytetarë në shiqim publikë sipas listës evidente nga OE.
- Bazuar në raportet e Kontrollit të Kualitetit, procesi i Kontrollit është duke u realizuar në bazë të kornizave të punës nr. AKK 01/2013 dhe 02/2013 dhe listave të kontrollit (Checklistat), të cilat janë të hartuara nga ekspertët e AKK-së dhe BB-së bazuar në udhëzimet dhe katalogjet e AKK-së.
- Procesi i Kontrollit ka përfunduar për të gjitha ZK të dorëzuara nga OE, përveq lëndët e një ZK-jë që janë në proces të kontrollit (ZK Muzeqinë).
- Sëfundmi më datë 26.06.2015, OE ka raportuar se në terren janë duke operuar 6 ekipe në ZK Shtime.

Me Respekt,